VENDIM
Nr. 455, datë 26.7.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SISTEMIM DHE ASFALTIM BRENDA LAGJES 'ISA BOLETINI', FAZA IV", BASHKIA VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim dhe asfaltim brenda lagjes 'Isa Boletini', faza IV", Bashkia Vlorë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "truall", me sipërfaqe 16.5 m^2, dhe "ndërtim", me sipërfaqe 93.5 m^2, me vlerë të përgjithshme 3 766 884 (tre milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 3 766 884 (tre milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Vlorë, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Vlorë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Vlorë, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Pronarët e pasurive së paluajtshme, që shpronësohen, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumen-tacionin e pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E EMËRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "SISTEMIM DHE ASFALTIM BRENDA LAGJES 'ISA BOLETINI', FAZA E IV", BASHKIA VLORË

Nr.	Emri, mbiemri	Zona kadas-trale	Nr. i pasurisë	Sip. e trua-llit	Çmimi i truallit/ lekë	Vlera e trua-llit	Sip. e ndërt/m²	Çmimi i ndërt./lekë	Vlera e ndërtim-it	Vlera e përgjith-shme /lekë	Lloji i dokumentit
1	Bashkëpronarët: Stefan Miho Morfo Miho	8602	3/30-T	16.5	10 903	179 900				179 900	Vërtetim pronësie
		8602	3/30-G				16.5	31 795	524 618	524 618	Vërtetim pronësie
		8605	3/12-ND				77	39 721	3 062 367	3 062 367	Vërtetim pronësie
	TOTALI									**3 766 884**	